

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Practice**

B3

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 21/11/2021

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Si pjesë e procesit për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet auditorit dhe të audituarit, është shumë e rëndësishme për t'u marrë me mënyrën se si perceptohet auditimi i brendshëm. Disa lloje të qëndrimeve në punën e kryer do të ndihmojnë në krijimin e këtyre perceptimeve. Nga perspektiva e menaxhmentit, cili qëndrim ka të ngjarë të jetë më i favorshëm për një perceptim pozitiv?
 - A. Qëndrimi objektiv.
 - B. Qëndrimi hulumtues.
 - C. Qëndrimi pyetës.
 - D. Qëndrimi konsultativ.**
2. Gjatë një auditimi, auditori i brendshëm i një kompanie tregtare gjeti një skemë në të cilën drejtori i depos dhe agjenti i blerjeve ia ndërruan drejtimin mallrave në vlerë rreth 500,000 Eur për në depon e tyre dhe pastaj i shitën këto mallra palëve të treta. Mashtrimi nuk ishte zbuluar më parë për shkak se drejtori i depos i kishte dërguar fletëpranimet e mallit (pas përditësimit të regjistrave të përhershëm të stokeve) në departamentin e llogarive të pagueshme për procesim. Supozoni se autorët e mashtrimit u rrëfyen tek auditori. Cili është veprimi i duhur nga ana e auditorit?
 - A. Kërkoni që autorët e mashtrimit të nënshkruajnë përmbledhjen e auditorit për rrëfimin dhe përfshijeni këtë në letrat e punës. Raportoni detajet pastaj tek menaxhmenti i lartë për veprime të mëtutjeshme.**
 - B. Hiqeni dokumentacionin nga letrat e punës sepse është subjektiv, i ndjeshëm dhe mund të bëhet dëshmi ligjore. Raportoni detajet tek menaxhmenti dhe kërkoni që ata të kërkojnë këshillë ligjore për të dokumentuar rrëfimin.
 - C. Raportoni gojarisht rrëfimin tek menaxhmenti dhe sugjeroni që ata t'ia raportojnë atë autoriteteve ligjore, për shkak se është përfshirë një krim. Mos e dokumentoni.
 - D. Informoni autorët e mashtrimit për të drejtat e tyre, dokumentoni rrëfimin e tyre përmes inqizimit dhe informoni autoritetet lokale ligjore për krimin.
3. Kritika e fundit ndaj departamentit të auditimit të brendshëm theksoi se mbulimi nga auditimi nuk është duke ofruar reagim adekuat për menaxhmentin e lartë në proceset e përdorura në linjat kryesore të biznesit. Problemi u definua më tutje si mungesë e reagimit (feedback) në implementimet aktuale të sistemeve të automatizuara të ndihmës. Cilat janë dy funksionet që drejtori i auditimit të brendshëm duhet t'i përmirësojë?
 - A. Mbulimin me staf dhe komunikimin.
 - B. Mbulimin me staf dhe vendimmarrjen.
 - C. Planifikimin dhe organizimin.
 - D. Planifikimin dhe komunikimin.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

4. Një kompani e shitjeve me pakicë sapo ka implementuar sistemin e shkëmbimit elektronik të të dhënave (EDI) për të lëshuar urdhër blerje për furnitorët kryesorë. Zhvilluesi i sistemit ka zhvilluar një bazë të dhënash të furnitorëve të aprovuar. Furnitorët e rinj mund të shtohen vetëm pas një rishikimi të hollësishëm nga menaxheri i blerjeve dhe drejtori i marketingut. Vetëm agjentët e blerjeve mund të lëshojnë urdhër blerje dhe shuma e urdhër blerjeve për një linjë të caktuar produktesh nuk mund të kalojë shumën e buxhetuar të përcaktuar nga menaxheri i marketingut.

Të gjitha blerjet shkojnë në qendrën e shpërndarjes, ku skanohen elektronikisht në sistemin kompjuterik. Të gjithë artikujt hyrës duhet t'i referohen urdhër blerjes së kompanisë dhe artikujt që nuk përmbajnë një referencë të tillë nuk pranohen. Nuk përdoren fletëpranimet me numër të paracaktuar, por të gjitha faturat i referohen urdhër blerjes. Etiketat e çmimit gjenerohen sipas porosisë së blerjes dhe për sasi të shënuara në raportin e pranimi elektronik të skanuar. Numri i etiketave të krijuara të çmimeve përputhet me numrin e produkteve të marra.

Furnitori dërgon një faturë tek shitësi me pakicë. Faturat regjistrohen në sistem. Softueri kompjuterik është i programuar që të përputhë faturën e furnitorit, urdhër blerjen dhe raportin e pranimi. Nëse të tre këto dokumente përputhen brenda një tolerance prej 0.5%, programi kompjuterik i planifikon artikujt për pagesë brenda kohës për të përfituar nga zbritjet në blerje. Çeku gjenerohet nga programi i pagesave me para të gatshme dhe nënshkruhet e dërgohet me e-mail në formë elektronike. Nëse ka një mospërputhje midis të tre dokumenteve, shtypet një raport i cili i dërgohet departamentit të llogarive të pagueshme për hetim.

Procedura më e mirë për të përcaktuar nëse procedura e kontrollit për të kufizuar sasinë e blerjeve për një linjë produktesh të veçantë, është duke funksionuar siç duhet gjatë vitit të kaluar, do të ishte:

- A. Përdorimi i softuerit të përgjithësuar të auditimit për të përgatitur një listë të blerjeve sipas linjës së produktit. Të krahasohen shumat e blera me shumat e autorizuara nga menaxheri i marketingut.**
 - B. Paraqitja e të dhënave testuese në programin që kontrollon blerjet. (Shuma e të dhënave hyrëse duhet të kalojë blerjet e autorizuara.) Të shqyrtohen rezultatet e nxjerra nga kompjuteri.
 - C. Përdorimi i teknikave paralele të simulimit për të llogaritur shumën e blerjeve të autorizuara dhe krahasimi i asaj shumë me shumën e blerë në të vërtetë.
 - D. Zbatimi i një qasje të auditimit të çastit, i cili do të shënojë transaksionet e përzgjedhura dhe printimi i atyre së bashku me një listë të artikujve të rregulluar nga agjenti blerës.
5. Gjatë kryerjes së një auditimi, një auditor i brendshëm informohet për veprimet e paligjshme që kryhen nga disa prej zyrtarëve më të lartë të kompanisë. Kujt duhet t'i adresohen gjetjet e raportit të auditimit?
- A. Mbikëqyrjes të nivelit horizontal (të njëjtë).
 - B. Anëtarëve të departamentit për media.
 - C. Zyrtarëve të përfshirë në aktet e paligjshme.
 - D. Komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Auditori i brendshëm është përgjegjës për raportimin e mashtrimit tek menaxhmenti i lartë ose bordi kur:
 - A. Me një siguri të arsyeshme janë përcaktuar shumtë materiale të rastit të mashtrimit.**
 - B. Aktivitete të dyshimta janë raportuar në auditimin e brendshëm.
 - C. Transaksionet e parregullta janë identifikuar dhe janë nën hetim.
 - D. Rishikimi i të gjitha transaksioneve të dyshuara për mashtrim është përfunduar.

7. Drejtori i auditimit të brendshëm të një kompanie prodhuese zbuloi një aktivitet mashtrues mjaft të rëndësishëm që përfshin në mënyrë të qartë zëvendës drejtorin ekzekutiv të cilit Drejtori i auditimit i raporton. Cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan se si duhet të veprojë Drejtori i auditimit të brendshëm?
 - A. Kryen një kontroll me qëllim të përcaktimit të shkallës së mashtrimit.
 - B. Interviston zëvendës drejtorin ekzekutiv për të marrë dëshmi të nevojshme.
 - C. Njofton autoritetet rregullatore dhe policinë.
 - D. Raporton faktet tek drejtori ekzekutiv dhe komiteti i auditimit i bordit të drejtorëve.**

8. Një auditor i brendshëm është duke intervistuar tre individë, një prej të cilëve është i dyshuar për kryerjen e një mashtrimi. Cila nga të mëposhtmet është qasja më pak efektive e intervistimit?
 - A. Kërkesa ndaj secilit individ për të përgatitur një deklaratë me shkrim që shpjegon veprimet e tij ose të saj.
 - B. Marrja e rolit të personit që kërkon të vërtetën.
 - C. Dëgjimi me kujdes atë që ka për të thënë i intervistuari.
 - D. Përpjekja për të shtyrë të dyshuarin të rrëfejë.**

9. Një universitet është duke e parë si jopraktike të ketë një funksion të centralizuar të pranimit për blerjet e departamentit për libra, furnizime dhe pajisjeve. Cila nga kontrollet në vijim do të parandalonte më efektivisht pagesën për mallrat që nuk janë marrë, nëse kontrolli kryhet para se të ekzekutohet pagesa e faturës?
 - A. Faturat e furnitorit duhet të përputhen me urdhër-blerjet e departamenteve.
 - B. Emrat dhe adresat e furnitorëve të paraqitur në fatura duhet të krahasohen me një listë të furnitorëve të autorizuar nga departamenti.
 - C. Mbikëqyrësi i departamentit, i ndryshëm nga punonjësi i cili i porosit mallrat, duhet të miratojë faturat e furnitorit.**
 - D. Zëvendës-shefi i i financave duhet të miratojë faturat mbi një shumë të caktuar.

10. Qëllimi kryesor i studimit dhe vlerësimit të operacioneve të teknologjisë informative (TI) të kompanisë nga auditori i brendshëm, është që:
 - A. Të vlerësoj besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe operativ.**
 - B. Të vlerësoj kompetencën e personelit operativ të TI.
 - C. Të siguroj ushtrimin e kujdesit të duhur profesional.
 - D. Të familjarizohet me mjetet e kompanisë për identifikimin, matjen, klasifikimin dhe raportimin e informacionit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Një auditor i brendshëm është duke përgatitur procedurat për të verifikuar integritetin e të dhënave në një aplikacion të bazës së të dhënave. Burimi më i mirë i informacionit për auditorin për të përcaktuar përkufizimet e fushave të të dhënave është:
- A. Nën-skemat e të dhënave.
 - B. Fjalori i të dhënave.**
 - C. Gjuha e përkufizimit të të dhënave.
 - D. Gjuha e manipulimit të të dhënave.
12. Cila nga aktivitetet e mëposhtme audituese (për t'u audituar) paraqet rrezikun më të madh për një korporatë prodhuese të sapo bashkuar dhe si rrjedhojë ka gjasa që të jetë subjekt i një auditimi?
- A. Kombinimi i fondeve të parave të gatshme.
 - B. Kombinimi i funksioneve blerëse.**
 - C. Kombinimi i funksioneve ligjore.
 - D. Kombinimi i funksioneve të marketingut.
13. Faza e parë e procesit të vlerësimit të rrezikut është identifikimi dhe kategorizimi i aktiviteteve për t'u audituar në një organizatë. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK do të konsiderohet si një aktivitet që duhet të auditohet?
- A. Agjenda e zhvilluar nga komiteti i auditimit për njërin nga takimet e tyre tremujore.**
 - B. Saldot e llogarive të librit të madh (kryesor).
 - C. Sistemet kompjuterike të informacionit.
 - D. Ligjet dhe rregulloret që ndikojnë në organizatë.
14. Softueri i fletëve llogaritëse elektronike 'spreadsheet' do të ishte më i përshtatshëm për cilën nga aktivitetet e mëposhtme të auditimit?
- A. Përgatitjen e sllajdeve për një prezantim të auditimit.
 - B. Përgatitjen e raportit narrativ që përmbledh rezultatet e një auditimi.
 - C. Përgatitjen e planit të zhvlerësimit për pasuritë jo-qarkulluese (asetet fikse).**
 - D. Ngarkimin e të dhënave nga një mikrokompjuter në një kompjuter kryesor.
15. Cila nga opsionet e mëposhtme më së miri përshkruan studimin paraprak?
- A. Një pyetësor i standardizuar i përdorur për të kuptuar objektivat e menaxhmentit.
 - B. Një mostër statistikore e qëndrimeve, aftësive dhe njohurive të punonjësve kryesorë.
 - C. Një proces i përdorur për t'u familjarizuar me aktivitetet dhe rreziqet në mënyrë që të identifikohen fushat të cilave duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje gjatë auditimit.**
 - D. Një kalim përmes sistemit të kontrollit financiar për të identifikuar rreziqet dhe kontrollet që mund t'i adresojnë këto rreziqe.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

16. Një kompani shumëkombëshe ka një marrëveshje me një rrjet të vlerës së shtuar (VAN) që siguron kodimin dhe transferimin e komunikimit për këmbimin elektronik të të dhënave të kompanisë (EDI) dhe transferimin elektronik të fondeve (EFT). Para transferimit të të dhënave në rrjetin e vlerës së shtuar, kompania kryen përpunimin paraprak online të transaksioneve. Auditori i brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e kontrolleve të përpunimit paraprak. Përveç kësaj, marrëveshja ndërmjet kompanisë dhe rrjetit të vlerës së shtuar thekson se auditorit të brendshëm i lejohet të kontrolloj dhe raportoj mbi kontrollet ekzistuese (të vendosura) në rrjetin e vlerës së shtuar në baza vjetore. Kontrata specifikon se qasja në rrjetin e vlerës së shtuar mund të ndodhë papritur, gjatë tremujorit të dytë ose të tretë të vitit fiskal të kompanisë. Kjo periudhë është zgjedhur kështu për shkak se nuk do të ndërhynte në përpunimin gjatë periudhave të transaksioneve kulmore të rrjetit të vlerës së shtuar. Kjo dispozitë nuk është shqyrtuar me auditimin e brendshëm. Plani vjetor i auditimit i miratuar nga bordi i drejtorëve specifikon se një auditim i plotë do të bëhet gjatë vitit aktual.

Cila nga kontrollet në vijim të përpunimit paraprak ka më së paku të ngjarë se do t'i ofroj auditorit siguri në lidhje me vlefshmërinë e transaksioneve?

- A. Verifikimi i kërkesit.
- B. Autentifikimi i informacionit.
- C. Procesimi i përjashtimeve.
- D. Dekriptimi i të dhënave.**

17. Kodi i etikës së një firme përmban deklaratën: *'Të punësuarit nuk duhet të pranojnë dhurata ose shpërblime me vlerë mbi 50 Euro nga personat ose firmat me të cilat firma bën biznes.'* Kjo dispozitë zakonisht hartohet për të parandaluar:

- A. zbritjet e tepruara në shitje që mund të ofrohen nga të punësuarit.**
- B. presionet për të realizuar fitime nga brenda organizatës.
- C. dëshirën për të pasur më shumë.
- D. mungesa e integritetit dhe e moralit personal.

18. Shefi Ekzekutiv për Auditime është përgjegjës për vlerësimet e rregullta të koordinimit midis punës së auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Vlerësime të tilla mund të përfshijnë vlerësimet e efikasitetit të përgjithshëm dhe të efektivitetit të veprimtarive të brendshme dhe të jashtme të auditimit, përfshirë këtu koston totale të auditimit. Tek kush duhet të komunikohen rezultatet e këtyre vlerësimeve nga Shefi Ekzekutiv për Auditim?

- A. Menaxhmenti i lartë.
- B. Bordi.
- C. Menaxhmenti i lartë dhe bordi.**
- D. Auditorët e jashtëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

19. Disa auditor të brendshëm të një ndërmarrje tregtare janë duke krahasuar dhe analizuar treguesit kyç të performancës të kompanisë (KIP / TKP) me normat e industrisë dhe me të dhënat e të njëjtës kompani nga njëra periudhë në tjetrën. Ky lloj angazhimi është:
- A. Angazhim i auditimit të performancës.**
 - B. Angazhim i auditimeve operative.
 - C. Angazhim i auditimeve të sigurisë.
 - D. Angazhim i auditimit për kujdesin e duhur (due diligence).
20. Në auditimin e të hyrave, respektivisht faturimit një nga rreziqet kryesore të cilat mund të ndodhin është se persona të pa – autorizuar mund t'i qasen sistemit të mandat – blerjeve me anë të internetit, duke përdorur një kompjuter personal. Cila nga opsionet e më poshtme paraqet kontrollin ose procedurat e kontrollit të cilat mund të ndikojnë në parandalimin e këtij rreziku?
- A. Rakordimi midis mandat – dërgesave dhe faturave.
 - B. Rakordimi i një mostre të zgjedhur nga faturat me dokumentet e kryerjes së shërbimit ose me fletët e marrjes së mallrave në dorëzim.
 - C. Ri – validimi i shpeshtë i qasjes me anë të kontrolleve logjike, si për shembull marrja prapash në telefon dhe vendosja e fjalëkalimeve.**
 - D. Ndarja e detyrave midis funksioneve të faturimit, akordimit ose miratimit të shitjeve me kredi, dërgimit të mallrave, dhe marketingut.
21. Në rastet kur auditorët si pjesë të auditimit ndjekin hyrjet kontabël nga librat e llogarive të arkëtueshme deri tek memorandumet e kreditit për tu siguruar që rimbursimet e klientëve bëhen vetëm nëse ka memorandume të kreditit, ka për qëllim të përcaktoj nëse:
- A. janë regjistruar të gjitha shitjet me para të gatshme.
 - B. rimbursimet e klientëve janë miratuar siç duhet.**
 - C. të gjitha shitjet e faturuara dhe arkëtimet në para të gatshme janë klasifikuar dhe përmbledhur me saktësi dhe janë raportuar në kohën e duhur.
 - D. klientëve i dërgohen rregullisht pasqyra të gjendjes së llogarisë së tyre.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

22. Blerjet e bëra me metodën Vetëm - Në - Kohë (JIT) eliminojnë situatat ku kompania mbetet pa stoqe. Qëllimi i parimeve të blerjes Vetëm -Në - Kohë (JIT) përfshin:
- I. Përzgjedhjen dhe vlerësimin e furnizuesve;
 - II. Praktikrat e tenderimit;
 - III. Procedurat e inspektimit të mallrave gjatë marrjes në dorëzim;
 - IV. Përgjegjësitë për mallrat që i janë dërguar tashmë kompanisë;
 - V. Reduktimin e shkresave dhe dokumentacionit;
 - VI. Praktikrat e analizimit të vlerave, dhe
 - VII. Nevojat për paketim.
- A. I, II, III, IV,V.
B. I, III, IV,VI.
C. I, II, III,V, VII.
D. Të gjitha më sipër.
23. Intervistimi i personelit operues, identifikimi i objektivave të palës që auditohet, identifikimi i standardeve të përdorura për të vlerësuar performancën, dhe vlerësimi i rreziqeve inherente që krijohen nga aktivitete operuese të palës së audituar janë veprimtari që kryhen zakonisht në cilën fazë të një auditimit të brendshëm?
- A. Faza e punës në terren
B. Faza e sondazhit paraprak
C. Faza e programimit të auditimit
D. Faza e raportimit
24. Në kryerjen e një auditimi, rreziku i auditimit përcaktohet më së miri si rreziku që një auditor:
- A. Mund të mos zgjedh dokumentet që janë me gabime si pjesë e testimit
B. Mund të mos jetë në gjendje të vlerësojë si duhet një aktivitet për shkak të kontrolleve të dobëta të kontabilitetit
C. Mund të mos arrijë të zbulojë një gabim ose dobësi të konsiderueshme gjatë një ekzaminimi
D. Mund të mos ketë ekspertizë për të audituar në mënyrë të duhur një aktivitet specifik
25. Departamenti i auditimit të brendshëm has në një kufizim të fushëveprimit nga menaxhmenti i lartë që do të ndikojë në aftësinë e tij për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e tij për një departament të audituar. Natyra e kufizimit të fushës duhet të:
- A. Shënohet në dokumentet e punës së auditimit, por auditimi duhet të kryhet ashtu siç është caktuar dhe kufizimi i fushëveprimit të përafrohet, nëse është e mundur.
B. Komunikohet me auditorët e jashtëm në mënyrë që ata të mund të hetojnë çështjen në mënyrë më të detajuar.
C. Komunikohet me menaxhmentin, duke thënë se kufizimi nuk do të pranohet sepse kjo do të dëmtonte pavarësinë e departamentit të auditimit.
D. Komunikohet, mundësisht me shkrim, me bordin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

26. Çdo letër individuale e punës duhet, së paku, të përmbajë:

- A. Shprehjen e opinionit të auditimit
- B. Një legjendë shenjash
- C. Një grafik të plotë të sistemit të kontroleve të brendshme për fushën që auditohet
- D. Një titull përshkrues**

27. Një auditor ka dorëzuar një draft të parë të një raporti të auditimit për të audituarin në përgatitje të një interviste përfundimtare. Më poshtë është një fragment nga ai raport:

Auditimi është kryer për të realizuar disa objektiva: të verifikoj ekzistencën e makinerive të papërdorura që ruhen në depo, të përcaktoj nëse makineritë ishin dëmtuar gjatë deponimit, të rishikoj procedurat e trajtimit që po kryhen nga personeli në depo, të përcaktoj nëse po ndiqen procedurat e duhura të kontabilitetit për makineritë e ruajtura në depo, të llogarisë vlerën aktuale të tregut të stogëve në depo dhe të krahasoj vlerën totale të makinerive me regjistrimet kontabël të ndërmarrjes. Është konfirmuar se nga 30 makinat e zgjedhura nga blerjet e regjistrave për mostrën, 10 ishin të pranishme në dyshemenë e depove dhe 5 të tjera ishin të gatshëm për përcjellje në objektin e prodhimit. Dymbëdhjetë të tjerët ishin dërguar në objektin e prodhimit në një kohë të mëparshme. Një ekzaminim i procedurave të kontabilitetit të përdorura në depo zbuloi dështimin e nëpunësit të kontabilitetit të depove për të rekonsiluar të dhënat mujore të stogëve, siç kërkohet nga politikat. Një mostër prej 25 makinash u ekzaminua për dëmtime të mundshme, dhe të gjitha, përveç njëres ishin në gjendje të mirë. Është konfirmuar nga auditorët se procedurat e trajtimit të përshkruara në manualin e politikave të depove duket se janë të përshtatshme, dhe personeli i depove me sa duket po ndjek ato procedura, përveç ekzaminimit të sendeve që merreshin për stogë.

Kur komunikoni me palët e audituara, si faktorët e situatës ashtu edhe karakteristikat e mesazheve mund të dëmtojnë procesin e komunikimit. Një auditor ka vetëm kontroll të kufizuar mbi faktorët e situatës, por ka një kontroll thelbësor mbi karakteristikat e mesazheve.

Cila nga sa vijon duket se është një mesazh karakteristik që auditori që përgatiti raportin e mësipërm ka anashkaluar?

- A. Sekuencën e mesazhit**
- B. Natyrën e audiencës
- C. Zhurmën
- D. Historinë e ngjarjeve paraprake që çojnë në takimin aktual

28. Rekomandimet në raportet e auditimit mund ose nuk mund të zbatohen në të vërtetë. Cila nga ato që vijojnë përshkruan më mirë rolin e auditimit të brendshëm në ndjekjen e rekomandimeve të auditimit? Auditimi i brendshëm:

- A. Duhet të përcjell për të konstatuar se janë ndërmarrë veprime të duhura për rekomandimet e auditimit.**
- B. Nuk ka rol; përcjellja është përgjegjësia e menaxhmentit.
- C. Duhet të ngarkohet me përgjegjësinë për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
- D. Duhet të kërkohet që auditorët e pavarur të ndjekin rekomandimet e auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

29. Ju jeni një mbikëqyrës i auditimit, duke shqyrtuar dokumentet e punës të një kontrolli të përgjithshëm të një stafi të auditimit për funksionin e shitjeve të firmës. Faqet nuk janë të numëruara ose referenca të kryqëzuara. Më tej, letrat e punës ranë dhe u grumbulluan rastësisht përpara se t'ju sillnin.

Ju vendosni t'i renditni letrat e punës në rendin e duhur sipas Standardeve të IIA. Faza e parë e këtij aktiviteti është identifikimi i secilës faqe si pjesë e (1) anketës paraprake, (2) rishikimi i përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, (3) rishikimi për efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm ose (4) rishikimi për cilësinë e performancës.

Faqja e tretë që ju zgjidhni është një kopje bosh e formularit të kontratës së shitjes që tani është në përdorim nga firma. Disa herë në formular janë hijezuar fjalët "kontroll kyç" të ndjekur nga një shpjegim i shkurtër. Ju e njihni shkrimin si atë të stafit të auditimit që kreu auditimin. Ky dokument i përket aktivitetit të mëposhtëm:

- A. Sondazhi paraprak.
- B. Shqyrtimi për përshtatshmërinë e sistemit.**
- C. Shqyrtimi për efektivitetin e sistemit.
- D. Shqyrtimi për cilësinë e performancës.

30. Cila nga sa vijon duhet të identifikohet si mangësi nga një mbikëqyrës i auditimit kur shqyrton një seri dokumentesh pune?

- A. Një memorandum që shpjegon pse u tejkalua koha e buxhetuar për një pjesë të auditimit.
- B. Një gjetje e auditimit e regjistruar në letrat e punës dhe draft raporti që heq kriteret e përdorura për vlerësim.**
- C. Një memorandum që shpjegon pse u hoq një hap i programit të auditimit.
- D. Një letër drejtuar auditorit që përshkruan fushën e auditimit.

31. Sigurimi i informacionit të dobishëm dhe në kohë dhe promovimi i përmirësimeve në operacione janë qëllimet e auditorëve të brendshëm. Për ta realizuar këtë në raportet e tyre, auditorët duhet:

- A. Siguroni menaxhmentin e lartë me raporte që theksojnë detajete operacioneve të kushteve të dëmtuara.
- B. Siguroni raporte që plotësojnë pritjet dhe perceptimet e menaxhmentit operacional dhe menxhmentit të lartë.**
- C. Siguroni menaxhmentin operativ me raporte që theksojnë shqetësimet dhe rreziqet e përgjithshme.
- D. Siguroni informacion me shkrim para se të diskutohet me palën e audituar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Deklarata e fushëveprimit të një raporti të auditimit duhet të:
- A. Përshkruaj objektivat e auditimit dhe tregon lexuesit pse u krye auditimi
 - B. Identifikoj aktivitetet e audituara dhe të përshkruaj natyrën dhe shtrirjen e auditimit të kryer.**
 - C. Përcaktoj standardet, masat ose pritjet e përdorura në vlerësimin e gjetjeve të auditimit.
 - D. Komunikoj vlerësimin e auditorit të brendshëm për efektin e gjetjeve në aktivitetet e shqyrtuara.
33. Gjatë kontrollit të trajtimit të parave të gatshme, auditori vëren se shuma të konsiderueshme parash ruhen brenda natës në një zonë pune që ka qasje të lirë në një rrugë të ngarkuar. Për më tepër, nuk ka asnjë sistem të sigurisë ose ndonjë roje të armatosur në afërsi. Kur diskuton me menaxherin përkatës, auditori informohet nga menaxhere se: "Ne kurrë nuk kemi pasur vjedhje ose humbje të parave nga ky fond; pse duhet të shpenzojmë shuma të panevojshme për të përmirësuar sigurinë?" Auditori duhet:
- A. Të jap një raport të përkohshëm verbal. Në raportin përfundimtar, të përqendrohet në masat korrigjuese që do të merren.**
 - B. Shpjegoj të gjitha faktet, por të lejoj menaxhmentit mundësinë që të tregojë historinë e tij në mënyrë që veprimi korrigjues të ketë më shumë të ngjarë të miratohet.
 - C. Meqenëse kompania kurrë nuk ka pësuar humbje nga procedurat e trajtimit të parave të gatshme, nuk ka nevojë të raportojë gjetjet.
 - D. Shpërndaj gjerësisht raportin; ky është një problem i madh për të cilin duhet të dinë të gjithë në kompani.
34. Kërkesat për nivelin e stafit, arsimin dhe aftësimin, si dhe punën e departamentit të auditimit duhet të përfshihen në:
- A. Statutin e departamentit të auditimit të brendshëm.
 - B. Manualin e politikave dhe procedurave të departamentit të auditimit të brendshëm.
 - C. Planin vjetor të departamentit të auditimit të brendshëm.**
 - D. Përshkrimin e vendeve të punës për pozicionet e ndryshme të stafit.
35. Puna e auditimit në terren ka identifikuar një numër të gjetjeve të rëndësishme. Duhet të bëhen akoma testet shtesë të auditimit nga programi origjinal i auditimit; megjithatë, të dhënat nuk janë të disponueshme. Vlerësoni opsionet e më poshtme dhe zgjidhni alternativën më të mirë.
- A. Mos e lëshoni raportin e auditimit derisa të gjitha testimet të jenë përfunduar.
 - B. Identifikoni teste të tjera alternative për të përfunduar përpara raportimit të gjetjeve të auditimit.
 - C. Lëshoni një raport të përkohshëm për menaxhmentin në lidhje me gjetjet negative të identifikuara.**
 - D. Kryeni teste të auditimit kur të dhënat përfundimtare janë në dispozicion.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

36. Në cilën pjesë të raportit përfundimtar, auditori i brendshëm duhet ti përshkruajë objektivat e auditimit?
- A. Qëllimi**
 - B. Fushëveprimi
 - C. Kriteret
 - D. Kushtet
37. Një auditor i brendshëm në një kompani të shitjeve me pakicë i raporton drejtorit të auditimit të brendshëm të korporatës. Auditori është caktuar të kontrollojë një departament rajonal. Raportet e auditimit duhet të dërgohen në zyrën e korporatës dhe kontrolluesin e departamentit në rajon. Auditori ka qenë në vendndodhje për gjashtë muaj dhe ka paraqitur raporte mujore, çdo muaj duke audituar një pjesë të operacionit siç është caktuar nga auditimi i brendshëm i korporatave. Këtë muaj, për herë të parë, auditori ka audituar kontrollat e stokeve, duke ndjekur procedurat e vendosura nga stafi i auditimit të brendshëm të korporatës. Pasi pa raportin e auditimit për kontrollin e stokeve, kontrolluesi i departamentit thirri dhe kërkoi një takim me auditorin. Në takim, kontrolluesi i departamentit kritikoi me zë të lartë dhe abuzivisht punën e auditorit, qëndrueshmërinë e metodave të auditorit dhe rezultatet e paraqitura në raporte. Në të kaluarën, ndërsa jo gjithnjë duke rënë dakord me përfundimet e auditorit, kontrolluesi i departamentit gjithmonë kishte diskutime racionale dhe zhvilloi hapa të duhur përcjellës për të korrigjuar problemet që auditori gjeti. Ky auditim i veçantë nuk ishte puna më e mirë e auditorit, dhe auditori e kupton këtë. Auditori duhet të:
- A. mbroj punën tani dhe të përpiqet ta përmirësoni atë në të ardhmen.
 - B. kërkoi nga kontrolluesi i departamentit të identifikojë fushat specifike në të cilat raporti është i mangët, dhe nëse kundërshtimet janë të justifikuara, të rishikoj raportin.**
 - C. shpjegoj problemet personale që e kufizuan auditorin të punojë në këtë raport ashtu siç pritej.
 - D. kërkoi kohë pushimi për t'u trajnuar në fushat më të dobëta.
38. Pasi u emërua, një drejtor i ri i auditimit të brendshëm gjeti një staf auditimi të papërvojë i cili ishte mbi buxhetuar për shumicën e auditimeve. Një përmbledhje e detajuar e letrave të punës të auditimit nuk zbuloi evidenca të rishikimeve progresive nga mbikëqyrësit e auditimit. Për më tepër, nuk ka evidencë që ekzistonte një program i sigurimit të cilësisë. Për të vlerësuar si duhet operacionet e një departamenti të auditimit të brendshëm, një program i sigurimit të cilësisë duhet të përfshijë:
- A. Mbikëqyrja periodike e punës së auditimit të brendshëm mbi bazën e mostrës.
 - B. Shqyrtime të jashtme të paktën një herë në tre vjet nga persona të kualifikuar që janë të pavarur nga organizata.**
 - C. Shqyrtime të brendshme, përveç personelit të auditimit të brendshëm, për të vlerësuar cilësinë e operacioneve të departamentit.
 - D. Rotacioni periodik i menaxherëve të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Departamenti i auditimit të brendshëm për një korporatë të madhe kohët e fundit përfundoi një auditim të shpenzimeve të udhëtimit të departamentit të shitjeve. Cili nga grupet e mëposhtëm duhet të marrë një kopje të raportit të auditimit?
- A. Drejtori i Shitjeve dhe Zv. Drejtori për marketing.**
 - B. Kryetari i bordit, Drejtori operativ dhe Zv. Drejtori për marketing.
 - C. Kryetari i bordit, kontrolluesi dhe Drejtori i shitjeve.
 - D. Zyrtari kryesor financiar, Drejtori i shitjeve dhe Drejtori Ekzekutiv.
40. Cila nga sa vijon është më thelbësore për të udhëhequr stafin e auditimit në ruajtjen e përputhshmërisë së përditshme me standardet e performancës së departamentit?
- A. Politikat dhe procedurat.**
 - B. Shqyrtime të kontrollit të cilësisë.
 - C. Përshkrimet e pozicionit të punës.
 - D. Vlerësimet e performancës.
41. Raportimi tek menaxhmenti i lartë dhe bordi është një pjesë e rëndësishme e detyrës së auditorit. Cila nga pikat e mëposhtme NUK kërkohet t'i raportohet menaxhmentit të lartë dhe / ose bordit?
- A. Një përmbledhje e raportit vjetor të orarit të punës të departamentit të auditimit dhe buxhetit financiar.
 - B. Ndryshime të rëndësishme të përkohshme në orarin e punës së aprovuar të auditimit dhe buxhetin financiar.
 - C. Pas përfundimit të një auditimi, por përpara lëshimit të një raporti të auditimit, auditorit të lartë përgjegjës të auditimit i'u ofrua një pozitë e përhershme në departamentin e audituar.**
 - D. Një plan i auditimit u aprovua nga menaxhmenti i lartë dhe bordi. Pas aprovimit, menaxhmenti i lartë njoftoi drejtorin e auditimit që të mos auditonte një departamente sepse aktivitetet e departamentit ishin shumë të ndjeshme.
42. Një kompani kohët e fundit përjetoi një fitim neto të reduktuar ndjeshëm nga shitjet e linjës së produktit A. Linja A është prodhuar në një dyqan të dedikuar për makineri. Auditorëve të brendshëm i' u është ngarkuar detyra të përcaktojnë shkakun e fitimit neto të zvogëluar. Cila nga sa vijon do të identifikonte me shumë mundësi problemin?
- A. Një përmbledhje e rezultateve të auditimit paraprak.
 - B. Një ecje nëpër proceset e dyqanit të makinave.
 - C. Intervista me stafin e angazhuar në prodhimin e linjës A.
 - D. Një analizë e raporteve financiare dhe operacionale.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

43. Letrat e punës ofrojnë mbështetjen e dokumentuar për raportin e auditorit të brendshëm. Cila nga sa vijon NUK është një praktikë e mirë për letrat e punës?
- A. Letrat e punës duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur raportin e auditorit të brendshëm pa përpunim shtesë verbal nga auditori i brendshëm.
 - B. Letrat e punës duhet të mbahen të sigurta në çdo kohë për të parandaluar humbjen aksidentale ose qasjen e paautorizuar.
 - C. Letrat e punës duhet të organizohen në mënyrë kronologjike, d.m.th., me letrat e përgatitura më herët në pjesën e përparme të dosjes.**
 - D. Auditorët e brendshëm brenda një organizate të caktuar duhet të hartojnë metoda të standardizuara për organizimin dhe dokumentimin e punës.

44. Informatat e mëposhtme janë marrë nga pasqyrat financiare të një departamenti prodhues. Drejtori i auditimit të brendshëm është duke rishikuar të dhënat për të identifikuar rreziqet e mundshme si bazë për planifikimin e auditimit. Departamenti nuk është audituar nga departamenti i auditimit të brendshëm në tri vitet e fundit. Departamenti zhvillon pjesën më të madhe të biznesit të tij në mënyrë autonome. Departamenti historikisht është mbështetur në një produkt kryesor. Sidoqoftë, ai produkt po moshohet dhe së shpejti do të humbasë mbrojtjen e patentës.

Koeficientët	Viti aktual 2021	Viti i kaluar 2020	Viti paraprak 2019	Mesatarja e industrisë
Koeficienti i qarkullimit	1.94	1.89	2.28	2.13
Koeficienti i shpejt	0.66	0.88	1.22	1.4
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	112	93	72	69
Periudha e qarkullimit të stokeve	148	167	92	73
KMSH si% e shitjeve	0.375	0.402	0.412	0.445
Shitjet / pasuritë e prekshme	2.89	2.58	2.53	3.01
Shitjet / gjithsej pasuritë	1.33	1.31	2.53	2.78
Rritja e shitjeve	0.03	0.16	0.02	0.045
Fitimi neto ('000)	(€7,600)	€985	(€1,200)	€4,500

Departamenti pati një rritje të madhe të shitjeve në vitin e kaluar (2020).

Cila nga hipotezat e mëposhtme do të mbështesnin të dhënat lidhur me shkakun e mundshëm të shitjeve? Departamenti:

- A. Zbriti çmimin e shitjes për shumicën e linjës së saj të produkteve.
- B. Likuidoi një pjesë të konsiderueshme të stokeve të saj të vjetruara.
- C. Shiti pjesën më të madhe të pasurive afatgjata, duke realizuar një fitim nga shitja.
- D. Bleu një kompani tjetër dhe regjistroi blerjen si një transaksion blerjeje, jo një bashkim.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

45. Hetimi i krimeve të kryera me kompjuter përmban në vetvete çështje shumë teknike, gjë që e bën të domosdoshme që gjatë kontrolleve të ndërmerren hapat e duhur për të bërë të sigurt edhe trajtimin e duhur edhe ruajtjen e evidencave. Cila nga opsionet e mëposhtme përfshinë të gjitha elemente që duhet të merren në konsideratë për sa i takon kujdesit dhe trajtimit të evidencave:
- A. Zbulimi dhe njohja; Mbrojtja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja; Transportimi**
 - B. Zbulimi dhe njohja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja; Transportimi
 - C. Zbulimi dhe njohja; Mbrojtja; Regjistrimi; Mbledhja; Ruajtja; Transportimi
 - D. Zbulimi dhe njohja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja.
46. Super shkatërrimi (ang. SuperZapping), është një shembull i një sulmi të biznesit i cili përfshin:
- A. përdorimin e pa - autorizuar të një programi kompjuterik për shërbime (ang. utility program) për të modifikuar, shkatërruar, kopjuar, publikuar, futur, përdorur, ose mos lejuar përdorimin e të dhënave të ruajtura në një sistem kompjuterik ose në një media kompjuterike.**
 - B. mbledhjen e informacioneve të kartave të kreditit të klientëve nëpërmjet faqeve të internetit dhe përdorimi i pa - autorizuar i transfereve të fondeve në llogaritë personale që ndodhen në një institucion financiar.
 - C. ndryshimin e të dhënave para ose gjatë futjes në kompjuter ose gjatë përfundimit të rezultateve (outputeve) nga sistemi kompjuterik.
 - D. shkatërrimin e harduerëve ose objekteve.
47. Kryerja e krimeve me anë të kompjuterëve është e mundur në rastet kur:
- A. kontrollet janë të para- shikueshme dhe të shmangshme (bypassable).**
 - B. kontrollet janë dinamike.
 - C. ndryshimet e veçorive (karakteristikave) janë të shpeshta.
 - D. kërkojnë shuma të konsiderueshme parash si shpërblim për të dhënat.
48. Çfarë është teknika e fetave të sallamit?
- A. Marrja e shumave të vogla të pasurive.
 - B. Përdorimi i konceptit të rrumbullakimit të fraksioneve të centëve.
 - C. Vjedhja e disa centëve nga llogaritë bankare të klientëve.
 - D. Të gjitha opsionet.**
49. Për shkak të dobësive të kontrollit, është e mundur që menaxherët individualë të 122 restoranteve mund të kenë vendosur punonjës fiktivë në listën e pagave. Çdo restorant punëson 25-30 persona. Për të përcaktuar në mënyrë efikase nëse ky mashtrim ekziston në më pak se 1%, auditori duhet të përdorë:
- A. Mostrën sipas veçorive.
 - B. Mostrën sipas gjykimit.
 - C. Mostrën sipas drejtimit.
 - D. Mostrën për zbulim**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

50. Një hetues i sigurisë ose një zyrtar i zbatimit të ligjit, duhet të vëzhgojë cilën prej opsioneve të mëposhtmeve gjatë hetimit të një krimi kompjuterik?

- A. Zinxhirin e ngjarjeve.
- B. Zinxhirin e kujdestarisë (ruajtjes).**
- C. Zinxhirin e kompjuterëve.
- D. Zinxhirin e shkrimeve.